

VENDIM
Nr. 279, datë 12.4.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË OBJEKTEVE TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE,
PJESË E MARRËVESHJES SË LIDHUR MË 26.7.1993, NDËRMJET MINISTRISË SË
INDUSTRISË, BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKËS (SOT MINISTRIA E
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS) DHE ALBPETROL- IT, BASHKËSISË
EKONOMIKE TË NAFTËS DHE GAZIT (SOT SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, që i bashkëlidhet marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe të Gazit (sot shoqëria “Albpetrol”, sh.a.), sipas përmbajtjes së listave “A”, “B” dhe “C” që i bashkëlidhet këtij vendimi (faqja 1 deri 5).

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha